



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SKRAPAR  
KËSHILLI

**VENDIM**  
NR 76 Datë 23.08.2018

**Mbi dhënien e Pagesave për aftësinë e kufizuar për muajin Gusht 2018**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 7 dhe neni 29 pika 2 të ligjit 9355, datë 10.03.2005 “Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore”, i ndryshuar; V.K.M nr. 618 datë 07.09.2006 “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të masës së pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, i ndryshuar; Udhëzim nr. 366, datë 21.9.2017 “Mbi zbatimin e vendimit nr. 618, datë 07.09.2006, të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e kritereve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”; ligjin nr. 8089, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” i ndryshuar, VKM nr. 277 datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit” Udhëzimin nr. 367 datë 21.09.2017 “Mbi zbatimin e Vendimit Nr 277 te Këshillit te Ministrave Për përfitimet nga Statusi i të Verbërit”, i ndryshuar ; Ligjin nr. 8626 datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, V.K.M nr. 31 datë 20.01.2001 “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” i ndryshuar; Udhëzimin nr. 365 date 21.09.2017 “Mbi zbatimin e Vendimit Nr.31 datë 20.01.2001, të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik” i ndryshuar ;V.K.M nr. 869 datë 18.06.2008 “Për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Statusi i invalidit”.Këshilli i Bashkisë pasi mori në shqyrtim propozimin e Sektorit të Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë

**VENDOSI:**

1. Përfitojnë **pagesë paaftësie** për muajin Gusht 2018 në total 535 persona me 6 447 694 lekë, të ndarë në:

- Të paaftë 264 persona me fond 2 778 770 lekë në muaj
- Kujdestarë paaftësie 80 persona me nje fond 821 199 lekë në muaj
- Të verbër 115 persona me një fond 1 342 725 lekë në muaj



- Kujdestarë të verbër 28 persona me një fond 328 440 lekë në muaj.
- Para e tetraplegjike 24 persona me një fond 631 920 lekë në muaj.
- Kujdestarë para e tetraplegjike 24 persona me një fond 260 400 lekë në muaj.
- Kompesim për energjinë elektrike 115 persona me fond 274 240 lekë në muaj.
- Kompesim për telefon 10 persona me një fond 10 000 lekë në muaj.

2. Përfitojnë pagesë për shkak **Invaliditeti në punë** për muajin Gusht 2018 në total 342 persona me fond 1 052 300 lekë.

Vendimi u miratua me 11 vota pro, — vota abstenim, — vota kundër.

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

**KRYETARI I KËSHILLIT  
PARTIZAN GORÇE**

